

KOLEGJIT AAB
FAKULTETIT JURIDIK
Programi: Master juridik

KOLEGJI AAF
AAB COLLEGE
Prishtinë
Nr. 674/16 data: 20.04.2016

Me Vendimin e Këshillit Mësimor – Shkencor të Fakultetit Juridik, Nr.596/15, të datës 08.05.2015, jemi emëruar anëtarë të komisionit profesional për vlerësimin e punimit të diplomës për studime master të kandidatit Flakron Mjekiqi, nga Prishtina, të titulluar: **“Fitimi origjiner i Pronësisë”**, në përbërje Prof. Dr. Abdulla Aliu, kryetar, Prof. Dr. Muhamet Kelmendi, mentor-antar dhe Prof. Dr. Mehdi Hetemi, anëtar.

Komisioni profesional, pasi shqyrtoi dhe e analizoi punimin e masterit të kandidatit, si dhe duke u mbështetur në dispozitat aktuale të Statutit dhe të nenit 28 të Rregullorës për organizimin e studimeve master, pas plotësimit të të gjitha kushteve të përcaktuara dhe analizës së temës, paraqet këtë:

R e f e r a t

I

Flakron Mjekiqi, i lindur më 18.tetor.1986, në Prishtinë. KK Prishtinë, tani me banim në - Obiliq, shkollën fillore e ka krye në vendlindje.

Studimet univesitare i ka përfunduar në Kolegjin AAB.

Studimet pasuniversitare i ka filluar dhe mbaruar në programin Civilo-Juridik, pranë Kolegjin AAB, si dhe i ka përfunduar.

Në vitin 2012 deri më 2014 ka punuar si Përfaqesues juridik në Ndërmarrjen Publike “Tregu” në Prishtinë.

Në hyrje të këtij punimi kandidati Flakron Mjekiqi tregon se si është zhvilluar prona në sisteme të ndryshme juridike, dallimin më të theksuar në këtë aspekt për fitim të pronësisë, por edhe humbja apo shurja e saj është një proces i rregullar me anë të sistemeve juridike.

Si kategori të rëndësishme të pronës, shkruan autori, te e drejta pronësore është e drejtë e garantuar kushtetuse edhe në Republikën e Kosovës kjo e drejtë është e mbrojtur në bazë të rregullimit kushtetues andaj qëllimi i këtij punimi është elaborimi i të drejtës ligjore dhe mënyrat e fitimit dhe të mbrojtjes së saj.